

KRONIKË E ZEZË

Edhe një nxënës kapet me armë në Gjakovë



Drejtoria e Arsimit në Gjakovë ka dalë me apel për mobilizim dhe ndihmë nga nxënësit, mësimmdhënësit dhe prindërit për shkak se brenda një jave, dy nxënës janë kapur me armë në hapësirat shkollore.

Të premtën, personeli i shkollës së mesme teknike “Nexhmedin Nixha” gjatë kontrollit te një nxënës i klasës XI, ka gjetur një armë zjarri dhe menjëherë kanë njoftuar organet kompetente.

“Tani po merret Policia me rastin”, thuhet në reagimin e Drejtorisë për Arsim në Gjakovë.

Policia, e kontaktuar nga KOHA, ende nuk ka kthye përgjigje për rastin.

Më 22 mars, një nxënësi në gjimnazin “Hajdar Dushi”, Gjakovë, iu konfiskuan një armë e një thikë.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

25 mars 2022, 21:09

Shpërndaje në



TË TJERA



U vazhdohet edhe për dy muaj paraburgimi të dyshuarve për vrasjen e 18-vjeçares në Ferizaj



Vozitësi del në shinat e trenit në Pejë dhe goditet, jashtë rrezikut për jetë



Një serb dhe një boshnjak arrestohen për kalim të paautorizuar të kufirit



Policia ndalon një serbe që kishte hyrë në Kosovë ilegalisht

